

Tiranë më 26.10.2025

ANKIM

ANKUES: Gjergji Nikë Nika, me adresë për efekt njoftimi Rruga Muhedin Llagami, Kompleksi Square 21, Kulla 1 Tiranë i përfaqshuar nga Rezart Kthupi, me email: rezartkthupi@gmail.com dhe nr.cel: (+355) 692031881.

OBJEKTI: Kundërshtim i vendimit nr. __, date 26.10.2025, 'Për shqyrtimin e kërkesës për regjistrimin e Z. Gjergji Nikë Nika, si kandidat për Kryetar Bashkie, i propozuar nga zgjedhësit, në zonën zgjedhore Bashkia Vlorë, në zgjedhjet e pjesshme vendore për Kryetar Bashkie, për disa njësi të qeverisjes vendore të datës 9 Nëntor 2025.

Regjistrimin e Z. Gjergji Nikë Nika, si kandidat për Kryetar Bashkie, i propozuar nga zgjedhësit, në zonën zgjedhore Bashkia Vlorë, në zgjedhjet e pjesshme vendore për Kryetar Bashkie, për disa njësi të qeverisjes vendore të datës 9 Nëntor 2025.

BAZA LIGJORE: Nenet 21, pika 1, shkronja "b", 124, 133, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar; nenet 60 e vijues të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë"; vendimit nr. 3, datë 06.11.2020 të Komisionit Rregullator, "Për miratimin e rregullores "Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve".

DREJTUAR: KOMISIONIT TË ANKIMEVE DHE SANKSIONEVE

Të Nderuar,

Presidenti i Republikës me Dekretin nr. 350, datë 01.10.2025, ka caktuar datën 9 nëntor 2025, si datën e zhvillimit të zgjedhjeve të pjesshme vendore për kryetar bashkie, për disa njësi të qeverisjes vendore, të datës 9 nëntor 2025.

Me vendimin numër 32 datë 15.10.2025, "Për miratimin e disa afateve procedurale që lidhen me zgjedhjet e pjesshme vendore për Kryetar Bashkie, për disa njësi të qeverisjes



vendore, të datës 9 nëntor 2025”, Kolegji Zgjedhor Gjyqësor ka përcaktuar afatet për depozitimin e dokumentacionit për regjistrimin e kandidatëve të propozuar nga zgjedhësit.

Me shkresën nr. 6707 prot., datë 24.10.2025, Z. Gjergji Nikë Nika, ka paraqitur pranë KQZ-së kërkesën për regjistrimin si kandidat për Kryetar Bashkie, i propozuar nga zgjedhësit në zonën zgjedhore Bashkia Vlorë, në zgjedhjet e pjesshme vendore për kryetar bashkie, për disa njësi të qeverisjes vendore, të datës 9 nëntor 2025.

Bashkëlidhur shkresës nr. 6707 prot., datë 24.10.2025 është depozituar dhe dokumentacioni përkatës për regjistrimin e kandidatit Gjergj Nikë Nika.

Me datë 26.10.2025 jemi njohur me vendimin numër __ të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve me të cilin është vendosur “Mosregjistrimi e Z. Gjergji Nikë Nika si kandidat për Kryetar Bashkie, i propozuar nga zgjedhësit, në zonën zgjedhore Bashkia Vlorë, në zgjedhjet e pjesshme vendore për Kryetar Bashkie, për disa njësi të qeverisjes vendore të datës 9 Nëntor 2025”

ANALIZA LIGJORE

Vendimi numër __, datë 26/10/2025 i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve me të cilin është vendosur “Mosregjistrimi e Z. Gjergji Nikë Nika si kandidat për Kryetar Bashkie, i propozuar nga zgjedhësit, në zonën zgjedhore Bashkia Vlorë, në zgjedhjet e pjesshme vendore për Kryetar Bashkie, për disa njësi të qeverisjes vendore të datës 9 Nëntor 2025” është pasjoë e interpretimit të gabuar të dispozitave të Kodit Zgjedhor dhe si tillë duhet shfuqizuar.

Në pjesën arsyetuese të vendimi Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve arsyeton se:

“Në bazë të nenit 67, pika 7, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve regjistron kandidatin për Kryetar në Bashkinë Vlorë pasi Bashkia Vlorë, nuk mbulohet nga një KZAZ e vetme.

Vendimi i Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor nr. 32, datë 15.10.2025, “Për miratimin e disa afateve procedurale që lidhen me zgjedhjet e pjesshme vendore për Kryetar Bashkie, për disa njësi të qeverisjes vendore, të datës 9 nëntor 2025”, citon se Komitetet Nismëtare duhet të paraqesin kërkesën për regjistrim në KQZ për Bashkitë Vlorë, dhe Berat, si dhe në KZAZ-në përkatëse për bashkitë Tepelenë, Cërrik dhe Mat jo më vonë se data 16.10.2025. ...



Neni 70 i Kodit Zgjedhor të ndryshuar pika 3, citon se për paraqitjen e kandidati të propozuar nga zgjedhësit krijohet një Komitet Nismëtar me jo më pak se 9 zgjedhës nga zona zgjedhore përkatëse, të cilët janë ngarkuar për mbledhjen e firmave mbështetëse për kandidatin. Neni 70 pika 4, citon Kandidatët e propozuar nga zgjedhësit përjashtohen nga detyrimi i parashikuar në pikën 3 të këtij neni, nëse janë kryetarë bashkie, anëtarë të këshillit të njësisë së qeverisjes vendore përkatëse ose deputetë. Në këtë rast kandidati paraqet një vërtetim me shkrim, të nënshkruar nga institucioni i Kuvendit apo njësia e qeverisjes vendore, ku vërtetohet zotërimi i mandatit të paktën 6 muajt e fundit.

Brenda datës 16 tetor 2026, pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, duhej depozituar kërkesa për regjistrimin e Komitetit Nismëtar që do të përgatiste punën për regjistrimin e kandidatit të propozuar nga zgjedhësit z. Gjergji Nikë Nika, për Kryetar të Bashkisë Vlorë.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të depozituar rezulton se mungon regjistrimi i Komitetit Nismëtar, që do të përgatiste punën për regjistrimin e kandidatit për Kryetar të Bashkisë Vlorë.

Pas verifikimeve përkatëse të dokumentacionit në tërësi për regjistrimin e z. Gjergji Nikë Nika, si kandidat i propozuar nga zgjedhësit në zonën zgjedhore Bashkia Vlorë, në zgjedhjet e pjesshme vendore për kryetar bashkie, për disa njësi të qeverisjes vendore, të datës 9 nëntor 2025, konstatohet se dokumentacioni i paraqitur nuk është në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenin 70 pika 3 dhe 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar".

Në analizë të interpretimit të bërë nga KSHZ rezulton se ankuesi duhet të kishte regjistruar një Komitet Nismëtar, sipas afateve të parashikuara në vendimin nr. 32, datë 15.10.2025 të Kolegjit Zgjedhor Gjyqsor, brenda datës 16 tetor. Qëllimi i vetëm i këtij Komiteti Nismëtar nuk do të ishte ai i mbledhjes së firmave sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 70, por ai i dorëzimit të mandatit të anëtarit të këshillit bashkiak të parashikuar nga pika 4 e nenit 70.

Ky interpretim i nenit 70 të Kodit Zgjedhor nga ana e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve është tërësisht i gabuar pasi në përfundim ka realizuar bashkimin e dy pikave të nenit 70 të cilat janë pika që përjashtojnë njëra tjetrën.

Neni 70 i Kodit Zgjedhor është dispozitë brenda Pjesës IV të Kodit Zgjedhor, pjesë e cila rregullon regjistrimin e subjekteve zgjedhore. Vete neni 70 rregullon kushtet dhe mënyrën e regjistrimit të kandidatëve të propozuar nga zgjedhësit (kandidatëve të pavarur ose të pambështetur nga partitë politike).



Neni 70 përbëhet nga 4 pika

Pika e parë përvakton njëkohësisht të drejtën e zgjedhësve për të propozuar një kandidat sikurse edhe afatin kohor brenda të cilit duhet të bëhet ky propozim.

Pika e dytë përcakton kufizimet që ka kandidati i propozuar nga zgjedhësit për të mos qenë pjesë e anjsë partie apo koalicioni që konkuron në atë zonë zgjedhore si dhe për të mos mbështetur haptazi apo në mënyrë të tërthortë asnjë subjekt apo kandidat tjetër që konkuron në atë zonë.

Pika e tretë përcakton hapat proceduralë që duhet të plotësohen nga zgjedhësit për të paraqitur kandidatin e tyre. Në këtë këndvështrim ligji kërkon fillimisht krimin e një komiteti nismëtar të përbërë nga 9 persona, qëllimi i të cilit është mbledhja e nënshkrimeve të 1% të zgjedhësve të zonës zgjedhore në të cilën kërkohet të regjistrohet kandidati.

Pika e katërt përcakton rastin alternativ në të cilin regjistrimi i kandidatit të propozuar nga zgjedhësit mund të bëhet kur ai (personalisht) zotëron një mandat të Kryetarit të Bashkisë, Anëtarit të Këshillit Bashkiak apo Deputetit.

Në analizë të pikave 3 dhe 4 të nenit 70 rezulton se kemi dy menyra alternative për regjistrimin e kandidatit të propozuar nga zgjedhësit. Në alternativën e parë (pika 3) regjistrimi mund të bëhet duke mbledhur 1% të nënshkrimeve (por jo më pak se 50) të zgjedhësve të regjistruar në listën e zgjedhësve të njësisë së qeverisjes vendore në të cilën zhvillohen zgjedhjet. Alternativa e dytë është ajo e dispoznimit nga ana e kandidatit të një mandati të anëtarit të këshillit bashkiak për më shumë se 6 muaj. Në këtë rast ajo që kërkohet si dokumentacion shoqërues për kandidimit nuk është lista me nënshkrimi, shoqëruar nga mjetet e identifikimit, por vetëm vërtetimi i njësisë së qeverisjes vendore për disponimin e mandatit për një periudhë më të gjatë se 6 muajore përpara dekretimit të datës së zgjedhjeve.

Pikat 3 dhe 4 të nenit 70 janë mënyra alternative dhe konkurruese të regjistrimit të kandidatit të propozuar nga zgjedhësit dhe si të tilla nuk mund të bashkëekzistojnë. Pikërisht për këtë qëllim edhe ligjvënësi ka përdorur në fillimin e pikës 4 formulimin "përfshihen nga detyrimi i parashikuar në pikën 3 të këtij neni". Ky formulim krijon



pamundësinë e përdorjes në të njëjtën kohë edhe të parashikimeve të pikës 3 dhe atyre të pikës 4.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve në arsyetimin e vendimi objekt ankimi pretendon të shkrijë në një dispozitë të vetme duke kërkuar nga ankuesi që të zbatojë në të njëjtën kohë pikën 3 dhe pikën 4 të nënit 70 ndonëse këto të fundit, sikurse arsyetuam edhe më lartë, janë pika përjashtuese të njëra tjetrës dhe të papajtueshme mes tyre.

Në përfundim duke vlerësuar se vendimi objekti ankimi është pasojë e interpretimit të gabuar të ligjit material si dhe duke vlerësuar se nga ana e ankuesit është depozituar në formën e kërkuar nga ligji i gjithë dokumentacioni i nevojshëm për regjistrimin si kandidat i propozuar nga zgjedhësit për zgjedhjet e pjesshme vendore të datës 09.11.2025 në Bashkinë Vlorë

KËRKOJMË:

- Shfuqizimin e vendimit nr. __, date 26.10.2025, 'Për shqyrtimin e kërkesës për regjistrimin e Z. Gjergji Nikë Nika, si kandidat për Kryetar Bashkie, i propozuar nga zgjedhësit, në zonën zgjedhore Bashkia Vlorë, në zgjedhjet e pjesshme vendore për Kryetar Bashkie, për disa njësi të qeverisjes vendore të datës 9 Nëntor 2025.
- Regjistrimin e Z. Gjergji Nikë Nika, si kandidat për Kryetar Bashkie, i propozuar nga zgjedhësit, në zonën zgjedhore Bashkia Vlorë, në zgjedhjet e pjesshme vendore për Kryetar Bashkie, për disa njësi të qeverisjes vendore të datës 9 Nëntor 2025.

GJERGJI NIKA

Përfaqësuar nga Av. Rezart Kthupi

